



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AGJENCIA E SIGURIMIT TË CILËSISË SË ARSIMIT PARAUNIVERSITAR

Tiranë, më. 19.06.2025

Njoftim për bashkëpunëtorë

Në kuadër të programit “Promovimi i sigurisë së nxënësve në shkolla, mbështetja e forcimit të qendrave burimore që ofrojnë arsim gjithëpërfshirës dhe zgjerimi i nismës Akelius në Shqipëri” i zbatuar nga Agjencia për Sigurimin e Cilësisë në Arsimin Parauniversitar (ASCAP) me mbështetjen e Unicef në Shqipëri, ASCAP kërkon bashkëpunëtorë të jashtëm.

Bashkëpunëtorët duhet të plotësojnë këto kërkesa:

1. Të kenë mbaruar arsimin e lartë.
2. Të kenë përvojë paraprake në punën për sigurinë e nxënësve në shkolla dhe zbatimin e protokolleve që mundësojnë parandalimin e dhunës dhe konflikteve.
3. Të kenë përvojë në fushën e arsimit gjithëpërfshirës dhe në veçanti të mbështetjes së edukimit të fëmijëve me aftësi të kufizuara.
4. Të kenë përvojë dhe njohin platformën Akelius për mësimin e gjuhëve të huaja.
5. Të kenë marrë pjesë në projekte dhe veprimtari që lidhen me zhvillimin profesional të mësuesve në arsimin parauniversitar (përgatitje e materialeve për trajnimin e mësuesve, zhvillim i trajnimeve etj.)
6. Të kenë aftësi bashkëpunuese dhe aftësi të punës në grup.
7. Preferohet zotërimi i gjuhës angleze.

Kandidatët duhet të dorëzojnë CV-në dhe këto dokumente: fotokopje e diplomës së shkollës së lartë dhe të dokumentit të identitetit pranë sekretarisë së Agjencisë së Sigurimit të Cilësisë në Arsimin Parauniversitar (ASCAP) , brenda datës 24.06.2026, ora 16.30 (6 dite kalendarike).

Faleminderit!